



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3511/19 prot.

Datë 09.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 494/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2026, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. 126/2026, datë 23.01.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07- 2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

**Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik, adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë

**Kërkuesi:** Operatori ekonomik “MC Networking” SHPK me NIPT K722230070 dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

I.1. Në datën 09-05-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

I.2. Në datën 17-07-2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

I.3. Në datën 08.08.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	skualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.p.k	119,100,000 lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00 lekë	skualifikuar

I.4. Në datën 18.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

I.5. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2304/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5736 e operatorit ekonomik “ONE ALBANIA” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje InternetIntranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “One Albania” SHA, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të “Abissnet” SHPK.

I.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2304/1 datë 28.08.2025, lidhur arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “ONE ALBANIA” SHA kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Abissnet” SHA.

I.7. Në datën 27.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2307/2025 protokoli, datë 28.08.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5737 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje InternetIntranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. **Në Euro: 1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

I.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2307/1 datë

28.08.2025, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK kundërshton me anë të ankesës, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.

I.9. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/2 prot., datë 03.09.2025.

I.10. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2304/3 prot., datë 03.09.2025

I.11. Me shkresën me nr. 843/28 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2304/4 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “One Albania” SHA dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “One Albania” SHA nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

I.12. Në datë 02.09.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik “Abissnet” SHA ka dorëzuar formularin e paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar me tonën me nr. 2307/2 prot., datë 03.09.2025.

I.13. Me shkresën me nr. 843/29 prot., datë 04.09.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 2307/3 prot., datë 08.09.2025 drejtuar operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Mc Networking” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

I.14. Me vendimin nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “One Albania” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.*

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “One Albania” SHA.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.15. Me shkresën me nr. 843/33 prot., datë 16.10.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/9 prot., datë 17.10.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar KPP se: “[..] ju informojmë se në zbatim të vendimit nr. 1409, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka ngritur urdhrin e brendshëm për rivlerësimin e ofertave dhe ka kthyer fazën e procedurës për rivlerësim në SPE.” Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar: Urdhrin e brendshëm për rivlerësim ofertash nr. 5/32, datë 13.10.2025, si dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave datë 15.10.2025.

I.16. Në datë 22.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1516/2025, ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: **1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimin nr. 1409/2025, datë 08.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.17 Në datën 28.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	kualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.p.k	119,100,000 lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00 lekë	skualifikuar

I.18. Me shkresën me nr. 843/35 prot., datë 07.11.2025 me lëndë “Informacion mbi zbatimin e vendimit nr. 1516/2025 datë 22.10.2025 lidhur me rivlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit REF-47282-05-07-2025 me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 2304/14 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka informuar se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1409/2025, datë 08.10.2025.

I.19. Në datë 11.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1643/2025, ku vendosi:

- 1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.*
- 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.20. Në datën 20.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “One Albania” sh.a	71,995,200 lekë	skualifikuar
2. “MC NETWORKING”	83,619,173.80 lekë	skualifikuar
3. “Abissnet” sh.A	93,831,840 lekë	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” sh.p.k	119,100,000 lekë	skualifikuar
5. “Albanian Fiber Telecommunications” sh.p.k	119,700,457.00 lekë	skualifikuar

I.21. Në datë 27.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

I.22. Në datën 09.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3511/2025 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6154 e operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 Lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK.

I.23. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3511/1 datë 10.12.2025, lidhur arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MC NETWORKING” SHPK kundërshton me anë të ankesës.

I.24. Me shkresën me nr. 843/40 prot., datë 15.12.2025 me lëndë “Shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 3511/3 prot., datë 16.12.2025 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC Networking” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

I.25. Me shkresën me nr. 843/41 prot., datë 18.12.2025 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt : “Blerje internet-intranet, marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat për 4 vite”, protokolluar me tonën me nr. 3511/3 prot., datë 16.12.2025 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “MC Networking” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

I.26. Me shkresën me nr. 3511/5 prot., datë 29.12.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA informacionin si vijon: “[..] Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj nga operatori ekonomik “MC NETWORKING” SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar [..]”.

I.27. Me shkresën me nr. 846/44 prot., date 06.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3511/6 prot., datë 06.01.2026 autoriteti kontraktor Posta Shqiptare SHA ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacion e dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Networking” shpk pranë Postës Shqiptare SHA në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

I.28. Me vendimin nr. Nr. **126/2026**, datë 23.01.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: **1,228,909.46** (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.29. Me shkresën datë 01.04.2026 me lëndë “Kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 664/2025 dhe nr. 126/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 999 prot., datë 01.04.2026, operatori ekonomik “MC Networking” SHPK ka parashtruar pretendimet si vijon: “[..] Në datën 17-02-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-38092-02-14-2025, me objekt “Blerje e sistemit të transkriptimit të të dhënave audio-video të kuvendit, bazuar në inteligjencën artificiale dhe “Shërbim mirëmbajtje për 48 muaj”, me fond limit 74,478,400.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Dokumentet e tenderit të kësaj procedure janë ankimuar nga ana e shoqërisë Mc Netëorking dhe KPP është shprehur me vendimin e saj nr. 664/2025.

*Ndërkohë në datën 09-05-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare”*

*Vendimmarrjet e KVO-së në këtë procedurë janë bërë objekt ankimi nga ana e shoqërisë MC NETWORKING dhe Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me vendimin nr. 126/2026.*

*Shumë kohë më vonë pas nxjerrjes së këtyre vendimeve jemi vendosur në dijeni të fakteve të cilat e bëjnë të cënueshme ato duke na lindur e drejta për të kërkuar rishikimin e tyre [...].*

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëngjitur,

#### **Arsyeton**

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

II.1.1. Lidhur me shkresën datë 01.04.2026 me lëndë “Kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 664/2025 dhe nr. 126/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 999 prot., datë 01.04.2026, operatori ekonomik “MC Networking” SHPK ka parashtruar pretendimet si vijon: “[..] Në datën 17-02-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-38092-02-14-2025, me objekt “Blerje e sistemit të transkriptimit të të dhënave audio-video të kuvendit, bazuar në inteligjencën artificiale dhe “Shërbim mirëmbajtje për 48 muaj”, me fond limit 74,478,400.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

*Dokumentet e tenderit të kësaj procedure janë ankimuar nga ana e shoqërisë Mc Networking dhe KPP është shprehur me vendimin e saj nr. 664/2025.*

*Ndërkohë në datën 09-05-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind*

*e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare”*

*Vendimmarrjet e KVO-së në këtë procedurë janë bërë objekt ankimi nga ana e shoqërisë MC NETWORKING dhe Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me vendimin nr. 126/2026.*

*Shumë kohë më vonë pas nxjerrjes së këtyre vendimeve jemi vendosur në dijëni të fakteve të cilat e bëjnë”, KPP nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj dhe argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoj” të vendimit, kjo në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 24/1 i LPP).*

II.1.2. Lidhur me argumentat e paraqitura në kërkesën tuaj ju sjellim në vëmendje se KPP, nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj e argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoj” të vendimit. Gjithashtu KPP, sjell në vëmendje të ankimesit se neni 30 pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se: “2.Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”.

II.1.3. Instituti i rishikimit nga ana e një organi administrativ, të një vendimi të nxjerrë nga vetë organi në fjalë, nuk gjen mbështetje ligjore në Kodin e Procedurave Administrative në fuqi, ndaj KPP vlerëson se duhet ti drejtohet me analogji Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:

*a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shpresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;*

*b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;*

*c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;*

*ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;*

*d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;*

*e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.*

*ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga RSH”*

II.1.4. Në kërkesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në argumentet e tij, nuk ofrohet apo vërtetohet nga ky operator ekonomik mbi ndonjë fakt apo rrethanë të re. Argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK në kërkesën për rishikim vendimi nuk bazohen në fakte apo prova nëpërmjet të cilave mund të provojë pretendimet e tij. KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Akoma më tej vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin. Referuar shkresës datë 01.04.2026 me lëndë “Kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 664/2025 dhe nr. 126/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 999 prot., datë 01.04.2026, operatori ekonomik “MC Networking” SHPK në asnjë moment nuk e ka mbështetur me prova apo fakte pretendimin e tij që ndodhemi në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Komisioni thekson, se situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të këtij ligji ka qëllim garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta, duke mbuluar çdo situatë ku personat që mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal, që mund të cenojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit. Kërkesa e operatorit ekonomik për rishikim të vendimit KPP nr. 126/2026, datë 23.01.2026 lidhur me ekzistencën e një konflikti interesi bazohet vetëm në aludime të pa mbështetura në fakte dhe prova.

Referuar kuadrit ligjor në fuqi, ekzistenca e konfliktit të interesit duhet të provohet në mënyrë të qartë dhe të argumentuar, përmes fakteve dhe rrethanave konkrete që dëshmojnë cënimin e paanshmërisë në proces. Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë indicie, asnjë provë materiale apo dokumentacion mbështetës që të vërtetojë pretendimin e tij. Nga verifikimi i kërkesës së dorëzuar nga operatori ekonomik, Komisioni konstaton, se nuk ekzistojnë rrethana apo fakte të reja për rishikim vendimi.

Akoma më tej, duke qenë se KPP është organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse. Akoma më tej, referuar nenit 30 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, ku përcaktohet shprehimisht se: “Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”, si dhe nenit 121 pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, ku përcaktohet se: “Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën

*Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”, sqarojmë se, ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik kanë cënuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK për rishikimin e vendimit të KPP-së Nr. 126/2026, datë 23.01.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-47312-05-08-2025, me objekt: “Blerje Internet-Intranet, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 4 vite”, me fond limit 119,990,720 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) lekë pa TVSH. Në Euro: 1,228,909.46 (një milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntë pikë dyzet e gjashtë) Euro pa T.V.SH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07.05.2025 është 1 Euro=97.64 Lekë/Euro, zhvilluar në datë 17-07- 2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

